

VENDIM
Nr. 72, datë 27.5.2016

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË OSHEE
SHA PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS PËR SHËRBIMIN E SHPËRNDARJES DHE
ÇMIMIT TË SHITJES ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI
I SHËRBIMIT UNIVERSAL PËR PERIUDHËN 1 KORRIK–31 DHJETOR 2016**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 20, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 18, 20 dhe 21, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit transmetimi, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të operatorit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, si dhe të “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të shitjes me pakicë për klientët tariforë”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.5.2016, pasi shqyrtoi aplikimin e OSHEE sh.a. për përcaktimin e tarifës për shërbimin e shpërndarjes dhe çmimit të shitjes me pakicë të energjisë elektrike nga furnizuesi i shërbimit universal për periudhën 1 korrik–31 dhjetor 2016, konstatoi se:

- Aplikimi plotëson kryesisht kërkesat e përcaktuara në rregullat e ERE-s, për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për përcaktimin e tarifës për shërbimin e shpërndarjes dhe çmimit të shitjes me pakicë të energjisë elektrike nga furnizuesi i shërbimit universal për periudhën 1 korrik–31 dhjetor 2016.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të OSHEE sh.a. për përcaktimin e tarifës për shërbimin e shpërndarjes dhe çmimit të shitjes me pakicë të energjisë elektrike nga furnizuesi i shërbimit universal për periudhën 1 korrik–31 dhjetor 2016.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë OSHEE sh.a. për vendimin e Bordit të ERE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti